

SHPALLJE PËR TENDER PUBLIK

Titulli I tenderit:	Furnizimi I AFK-së me pelet për ngrohje
Data e publikimit:	17.08.2017
Data e mbylljes:	22 Gusht 2017 në orën 16:00
Autoriteti kontraktues:	Agjencioni për financim në Kosovë –AFK

1. Deklaratë përmblledhëse:

- Agjencioni për financim në Kosovë - AFK kërkon kontraktues për furnizimin e AFK-së me pelet për ngrohje.

2. Kërkesat për ofertat financiare:

- Ju lutemi që ofertën tuaj ta dorëzoni tek zyrat e AFK-së në pajtim me specifikat e parashtruara në Shtojcën 1 të këtij dokumenti.
- Të gjitha ofertat të dorëzohen në Euro, përfshirë TVSH-në, në të kundërtën në rast se çmimet dorëzohen pa e specifikuar TVSH-në, AFK do të konsiderojë se çmimet përfshijnë TVSH-në.

3. Kushtet e përgjithshme:

Oferta duhet të përmbajë informatat në vijim:

- Adresa e plotë dhe detajet kontaktuese të ofertuesit.
- Të përmbajë numrin e ofertës dhe datën e ofertës.
- Çdo faqe e ofertës duhet të vuloset dhe të nënshkruhet nga personi i autorizuar.
- Ofertës duhet t'i bashkëngjitet Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe Çertifikata e numrit Fiskal (kopje).

4. Kushtet dhe rregullat e tenderit:

- Dokumentet duhet të vendosen në një zarfë të mbyllur dhe të dorëzohen në zyret e AFK-së .
AFK do të pranojë vetëm ofertat e juaja të mbyllura në zarf, dhe nuk do të konsideroj asnjë formë tjetër të aplikimit.
AFK nuk mban përgjegjësi për dëmtimin , humbjen apo mos pranimin e zarfeve.